VENDIM
Nr. 299, datë 10.4.2013

PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 74, DATË 1.2.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË "ALBPETROL" SHA, PATOS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 10 490, datë 15.12.2011 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë "Albpetrol" sh.a., Patos", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 74, datë 1.2.2013 të Këshillit të Ministrave, bëhet një ndryshim dhe një shtesë:
1. Pika 2 shfuqizohet.
2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:
"3. Mbylljen e procedurave të privatizimit të shoqërisë "Albpetrol" sh.a., Patos.".
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha